

u nis për t'i ndihmuar Markut dhe djemve, por u qëllua për vdekje. Në ndërkohë, një grup i policëve serb iu afrua shtëpisë. Tentonin ta vënin zjarrin në të. Marku e humbi durimin, doli nga shtëpia dhe u nis përmes oborrit drejt policëve serb. Ka rënë në mes të tij i qëlluar me një breshëri plumbash. Menjëherë pas rënies së tij, u afrua një autobлиндë. Policët i futën trupat e Markut dhe Kolës në të. I çuan në Gjakovë/Đakovica. Dy ditë më vonë, motra e Markut, Prena, me djemtë i kanë marrë trupat e Markut dhe Kolës dhe i kanë varrosur në varrezat e Vraniqit/Vranić.

**Burimet:** deklarata P.L, FDH-29050; SHFDUÇK, *Feniksët...10*, 65, 66; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; FHP, *Haški tribunal, Sudenja Slobodanu Miloševiću*, XX, 195.

## Brahim (Xhemë) Gjeka

(30.08.1921, shqiptar nga Batusha/Batuša, komuna e Gjakovës/Đakovica, bujk, gjashtë fëmijë)

Brahimi i moshuar më bashkëshorten e parë Nurijen, djalin Halilin dhe familjen e tij, si dhe bashkëshorten e dytë Nushen, jetonin në **Batushë/Batuša**. Në fund të muajit maj të vitit 1998, Halili, i cili ka qenë pjesëtar i UÇK-së, e ka dërguar Nurijen me familjarë të tjerë në fshatin Racaj/Racaj. Brahimi me Nushen kanë mbetur vetëm në shtëpi. Kur Halili, me një rast, erdhi te shtëpia, Nushja i tregoi se në oborin e tyre kishin hyrë tre policë serbë më **8.08.1998**. Kur Brahimi doli jashtë për të parë çfarë donin, ata e vranë në vend. Një ditë më vonë dhe me ndihmën e disa pleqve në fshat, Nushja e kishte varrosur Brahimin në varrezat lokale.

**Burimi:** deklarata A.B, FDH-15889.

## Rrustem (Feriz) Tolaj

(20.11.1920, shqiptar nga Batusha/Batuša, komuna e Gjakovës/Đakovica, bujk, shtatë fëmijë)

Rrustemi ka mbetur vetëm në fshat, kur familja e tij kaloi në Shqipëri në qershor të vitit 1998. Kohë pas kohe, atë e vizitonte nipi Bakiu, i cili ka qenë pjesëtar i UÇK-së. Në datën 10.08.1998, Bakiu mësoi nga disa pjesëtarë të UÇK-së se policët serbë e kishin vranë një

plak më **8.08.1998**, përderisa ai kujdesej për bagëtinë në një fushë pranë **Batushës/Batuša**. Ai shkoi menjëherë te vendi ku daja i tij e çonte rregullisht bagëtinë në kullotë. Atje e gjeti trupin e pajetë të Rrustemit, ishte i qëlluar me tre plumba në anën e majtë të trupit dhe një tjetër në dorën e djathtë. Me ndihmën e dy miqve, Bakiu e ka varrosur dajën në varrezat e fshatit.

**Burimi:** deklarata B.B, FDH-15516.

## Miroslav (Luka) Petrović

(20.10.1964, serb nga Runiku/Rudnik, komuna e Obiliqit/Obilić, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Miroslavi e ka kryer shkollën e mesme për minator, ndërkaq më vonë edhe trajnimin për oficer policie. U punësua në MPB-në e Serbisë në vitin 1991. Punonte në Stacionin e Dytë Policor në Prishtinë/Priština. U plagos gjatë përlëshjeve me pjesëtarët e UÇK-së, që u zhvilluan më **9.08.1998** te *Sukat e Biteshit/Biteške čuke*, në fshatin **Bitesh i Ulët/Donji Biteš**. Në datën 18.08.1998, ndërroi jetë nga plagët e rënda në AMU në Beograd.

**Burimet:** SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 53; Z. Stijović, *Kosmet...*, 110; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički...*, III, 938; *Dnevnik od 19. do 25. avgusta*, Ilustrovana politika, nr.2055, FDH-16958.

## Asllan (Dinë) Rexhepaj

(10.02.1979, shqiptar nga Hereçi/Ereč, komuna e Gjakovës/Đakovica, bujk, pjesëtar i UÇK-së)

Edhe pse vetëm 19 vjeç, Asllani u bë anëtar i UÇK-së pas vrasjes së familjes Jashari në Prekazin e Ulët/Donje Prekaze, në fillim të marsit të vitit 1998 [të shikohet regjistrimi në faqet 357-364]. Stërvitjet ushtarake i ka kryer në Glogjan/Glođane. Në disa raste ka shkuar për në Shqipëri për të transportuar armatime në Kosovë. Në mëngjesin e datës **9.08.1998**, diku rreth orës 6:00, nga vendi i quajtur *Sukat e Hereçit/Erečke čuke*, forcat serbe hapën zjarr mbi fshatin Hereç/Ereč. Në ato çaste, Asllani rastisi të ishte në shtëpi. Shkoi menjëherë për të zënë pozicionin e vet luftarak. Diku nga ora 18:00, luftëtarëve të UÇK-së nisën tu mungonin municione